

VENDIM
Nr.449, datë 27.4.2006

**MBI NDRYSHIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT TELEVIZIV KABLLOR
PRIVAT “AL-TE”**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë datë 30.3.2004, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.277, datë 29.10.2004 “Për dhënie licence për televizionin kabllor privat AL-TE”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e zonës së licencimit të shoqërisë “Alte Kabllor” sh.p.k., stacioni televiziv kabllor privat “AL-TE”, me nr.licence 020/RTVK.
2. Zona e licencimit të TV AL-TE, sipas pikës 1 të këtij vendimi, është qyteti Durrës, qyteti Laç dhe qyteti Gjirokastrë.
3. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve e saj.
4. Ngarkohet Departamenti Teknik, Departamenti Ekonomik dhe Departamenti Juridik dhe i Licencave për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj